

DOKUMENTI I POLITIKAVE PUBLIKE

# NEVOJA E SANKSIONIMIT TË PADISË KUSHTETUESE NË RENDIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



Instituti për të drejtat e njeriut



Auswärtiges Amt



Human Rights

Dokumenti i Politikave Publike

## NEVOJA E SANKSIONIMIT TË PADISË KUSHTETUESE NË RENDIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

**Editor:**

Instituti i të Drejtave të Njeriut

**Për editorin:**

Margarita Caca Nikollovska

**Redaktor:**

Antonio Pavlovski

**Autorë:**

Aleksandar L. Spasov

Ana Çupeska

**Përktheu:**

Blerina Starova Zlatku

**Dizajni grafik:**

Bisera Atanasovska

*Shkup, 2023*

---

*Dokumenti i Politikave Publike u hartua me mbështetjen financiare të Ambasadës Gjermane. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Institutit të të Drejtave të Njeriut dhe nuk i pasqyron pikëpamjet e Ambasadës ose Qeverisë Gjermane.*

# PËRMBAJTJA

<b>1. REZYME EKZEKUTIVE</b> .....	<b>4</b>
<b>2. HYRJE (KONTEKSTI JURIDIKO POLITIK)</b> .....	<b>5</b>
<b>3. PASQYRË PËRMBLEDHËSE E KUADRIT RELEVANT NORMATIV TË PADISË/ANKIMIT KUSHTETUES NË RENDE TË NDRYSHME JURIDIKE</b> .....	<b>7</b>
3.1. Republika e Sllovenisë.....	7
3.2. Republika e Kroacisë .....	8
3.3. Republika e Serbisë .....	9
3.4. Mali i Zi.....	10
3.5. Bosnja e Hercegovina.....	11
3.6. Republika Federale e Gjermanisë .....	13
<b>4. REKOMANDIME PËR SANKSIONIMIN E ANKIMIT GJITHËPËRFSHIRËS KUSHTETUES NË RENDIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE FUQIZIMIN E ROLIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT SI MBROJTËSE E TË DREJTAVE TË NJERIUT</b> .....	<b>15</b>

## REZYME EKZEKUTIVE

Dokumenti i Politikave Publike "Nevoja e Sanksionimit të Padisë(Ankimit) Kushtetuese në Rendin Juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është një analizë në kontekstin juridiko politik dhe nevojës për sanksionimin e mjetit juridik padisë kushtetuese përkatësisht ankimit kushtetues në rendin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke e marrë parasysh impenjimin e përgjithshëm për ta fuqizuar rolin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut si mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Autorët në këtë dokument prezantojnë një analizë krahasuese të kuadrit normativ lidhur me padinë kushtetuese përkatësisht ankimin kushtetues në rendet juridike të Republikës së Sllovenisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë e Hercegovinës, si dhe Republikës Federale të Gjermanisë. Përzgjedhja e këtyre shteteve, përkatësisht rretheteve të tyre juridike, konsiston me ndërlidhjen e tyre rajonale, por edhe me historikun e përbashkët juridiko-politik në një periudhë të gjatë kohore me shtetin tonë. Në rastin e Republikës Federale të Gjermanisë, autorët i referohen ndikimit të konsiderueshëm të së drejtës gjermane në përgjithësi mbi zhvillimin e traditës juridike kontinentale të cilës i përket edhe rendi juridik i vendit tonë, por edhe për shkak të historisë së gjatë e të suksesshme të ankimit kushtetues në rendin juridik gjerman të pasluftës dhe, në veçanti, rolit të Gjykatës Kushtetuese Federale të këtij vendi si mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të njeriut, me ç'rast kjo Gjykatë edhe nga perspektiva historike, ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në transformimin e shtetit dhe shoqërisë gjermane në një demokraci dhe shtet ligjor të zhvilluar dhe funksional pas përvojave të tmerrshme të diktaturës naziste.

Në fund të analizës, autorët paraqesin rekomandime për politikën publike, duke u nisur nga synimi tejet ambicioz i sanksionimit të padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues përmes amendimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në një periudhë kohore afatmesme ose afatgjatë, duke vazhduar me rekomandimet për fuqizimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese si mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të njeriut në një periudhë afatshkurtër ose afatmesme, para amendimit të Kushtetutës dhe duke përdorur kuadrin ekzistues normativ ose duke ndryshuar legjislacionin në fuqi. Së këtejmi, autorët propozojnë rekomandime që duhet t'i përgjigjen nevojës emergjente për politika publike në këtë fushë.

## 2.

### HYRJE (KONTEKSTI JURIDIKO-POLITIK)

Dokumenti i Politikave Publike "Nevoja e Sanksionimit të Padisë(Ankimit) Kushtetuese në Rendin Juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut"<sup>1</sup> është një analizë gjithëpërfshirëse e nevojës dhe mundësisë së sanksionimit të mjetit juridik padisë përkatësisht ankimit kushtetues<sup>1</sup> në rendin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Dokumenti përbëhet nga hyrja në kontekstin juridiko-politik në vendin tonë, nga një analizë e shkurtër krahasuese të kuadrit normativ të padisë përkatësisht ankimit kushtetues në rendet juridike të Republikës së Sllovenisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Malit të Zi, Bosnjë e Hercegovinës, si dhe Republikës Federale të Gjermanisë dhe skenarët e mundësisë së sanksionimit të këtij mjeti ligjor në rendin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe fuqizimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut si mbrojtëse e të drejtave të njeriut (rekomandime).

Analiza i referohet konkluzionit se ekziston nevojë objektive dhe praktike për zgjerimin e kuadrit normativ të rendit tonë juridik drejt inkorporimit të mjetit juridik padisë kushtetuese përkatësisht ankimit kushtetues, me synimin evident të avancimit dhe fuqizimit të mbrojtjes kushtetuese gjyqësore të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën tonë.

Shumë shtete demokratike e posedojnë këtë mjet juridik të cilin qytetarët e kanë në dispozicion të drejtpërdrejtë për t'i mbrojtur të drejtat dhe liritë e tyre themelore. Komisioni i Venecias është e mendimit dhe synon ta favorizojë të ashtuquajturin ankimin kushtetues të plotë ose gjithëpërfshirës. Argumentet që mbështesin këtë pikëpamje konsistojnë me atë se, së pari, ankimi kushtetues siguron mbrojtje më gjithëpërfshirëse të të drejtave kushtetuese, së dyti, për shkak të elementit të subsidiaritetit në kontekstin e sigurimit të të drejtave të garantuara nga GJEDNJ-ja. Në këtë kuptim, me këtë argument specifikohet një objektiv jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe pragmatik, i cili konsiston me atë se do ta shkarkojë Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) nga barra dhe detyrimet e shtuara të institucioneve vendase, përkatësisht, në radhë të parë, gjykatat vendase të jenë efikase dhe efektive në punën e tyre në fushën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore.<sup>2</sup>

Padia kushtetuese ose ankimi kushtetues janë mjet specifik juridik me të cilin qytetarët, ndër-sa në disa sisteme edhe personat juridikë, kanë të drejtë para Gjykatës Kushtetuese të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën si akti më i lartë juridik. Mbrojtja i referohet shkeljeve të kryera me akte individuale të autoriteteve shtetërore të nivelit qendror, autoriteteve publike jo të nivelit qendror (të nivelit lokal dhe/ose rajonal në varësi të sistemit të organizimit të qeverisjes), si dhe nga personat juridikë me autorizime publike. Për më tepër, në disa sisteme juridike, përveç shkeljeve të kryera me aktet e pushtetit ekzekutiv, mbrojtja mund të kërkojë edhe për shkak të shkeljeve të kryera me aktet e pushtetit gjyqësor. Padia/ankimi kushtetues në përgjithësi konsiderohet si një mjet efikas juridik që e forcon pozitën e individit dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me Kushtetutë.

Padia/ankimi kushtetues nuk përbën "ndërrhyrje" në gjyqësorin e rregullt, duke qenë se përgjegjësia kryesore për mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe lirive bie mbi gjykatat e rregullta. Nga aspekti komparativ, bëhet fjalë për një mjet juridik shtesë që mund të përdoret në përputhje me aktet normative ndërkaq Gjykatën Kushtetuese nuk e transformon në një "instancë të katërt

1 Në këtë dokument përdoren të dy nocione që janë në qarkullim për mjetet juridike përkatësisht padia kushtetuese dhe ankimi kushtetues dhe kudo që ato përdoren kanë të njëjtin kuptim.

2 European Commission for Democracy through Law, Revised Report on individual access to constitutional justice, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2021\)001-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2021)001-e)

gjyqësore” duke përcaktuar kompetencën e saj për të vendosur për shkeljet e lirive dhe të drejtave të garantuara me Kushtetutë (liritë dhe të drejtat themelore), duke i inkorporuar kriteret për pranueshmërinë e padisë/ankimit kushtetues, dhe mbi të gjitha përdorimin ose absolvimin e të gjitha mjeteve të tjera juridike në dispozicion përveç rasteve të jashtëzakonshme kur shkelja mund të çojë në dëm potencialisht të madh.

Padia/ankimi kushtetues si mjet juridik është i sanksionuar në disa sisteme juridike në Evropë. Në radhë të parë, në Republikën Federale të Gjermanisë ndërsa në rajonin tonë në Slloveni, Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë, Serbi, Malin e Zi, Shqipëri dhe Kosovë. Vetëm ky fakt vetvetiu flet në favor të sanksionimit të padisë/ankimit kushtetues në sistemin juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Deri më tani, ka pasur nisma për sanksionimin e saj (përmes nismave për amendimin e Kushtetutës) në vitin 2005 dhe 2014,<sup>3</sup> por pa sukses.

---

3 Për nismën lidhur me ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në vitin 2014, e cila, ndër të tjera, përmbante një propozim për inkorporimin e ankimit kushtetues në rendin juridik kushtetues më shumë shih në Propozimin të aksesshëm në: <https://www.akademik.mk/wp-content/uploads/2014/07/Predlog-ustavni-izmeni.pdf>. Nisma përmbante edhe propozime kontroverse të tilla si inkorporimi i një "zone financiare ndërkombëtare", propozim që në thelb synonte ta suspendojë rendin juridik të shtetit në një pjesë të territorit të tij në të cilin institucionet financiare do të vepronin sipas rregullave të posaçme. Ky propozim u kritikua nga ekspertët dhe publiku i gjerë dhe mund të përcaktohet si një nga arsyet pse procedura për ndryshimin e Kushtetutës nuk përfundoi me sukses.

## 3.

# PASQYRË PËRMBLEDHËSE E KUADRIT NORMATIV RELEVANT PËR PADINË/ANKIMIN KUSHTETUES NË RENDE TË NDRYSHME JURIDIKE

### 3.1. Republika e Sllovenisë

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Sllovenisë,<sup>4</sup> në nenin 160 një nga kompetencat e Gjykatës Kushtetuese ka të bëjë me vendimmarrjen lidhur me ankimet kushtetuese që rezultojnë nga shkeljet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut me akte individuale. Në këtë drejtim, Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë<sup>5</sup> i përcakton kushtet në të cilat mund të paraqitet një ankim kushtetues, si dhe procedurën për vendimmarrje sa i përket ankimit kushtetues. Sipas nenit 50, ankim kushtetues mund të paraqitet kundër akteve individuale me anë të të cilave autoritetet e pushtetit qendror, autoritetet e pushtetit lokal ose titullarët e pushtetit publik kanë vendosur për të drejtat dhe detyrimet e personave fizikë dhe juridikë. Është e rëndësishme të theksohet se edhe Avokati i Popullit ka të drejtë të paraqesë ankim kushtetues lidhur me çështjet ndaj të cilave vepron.

Rregulli i përgjithshëm në rendin juridik të Sllovenisë konsiston me atë se ankim kushtetues mund të paraqitet vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike në dispozicion të ankimuesit. Megjithatë, ka një përjashtim nga ky rregull, që ka të bëjë me mundësinë e paraqitjes së ankimit kushtetues edhe para se të shterohen mjetet juridike nëse do të shfaqeshin pasoja të riparueshme për ankimuesin nga zbatimi i aktit individual.

Në fazën e parë, Gjykata Kushtetuese, në një kolegji prej tre gjyqtarësh, vendos nëse do të ngrejë procedurë mbi ankimin e parashtruar kushtetues përkatësisht vendos për pranueshmërinë e ankimit. Rregulli i përgjithshëm konsiston me atë se ankimi nuk pranohet nëse shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk do të kishte pasoja të rënda mbi ankimuesin, me ç'rast Gjykata Kushtetuese kufizohet vetëm në shkeljet e rënda të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, duke mbrojtur në këtë mënyrë pozitën e ankimuesit individual, por edhe duke vendosur në raste të vështira duke përcaktuar standarde për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese nuk do të ngrejë procedurë nëse nuk respektohen kriteret procesuale në të cilat, përveç shterimit të mjeteve juridike, bën pjesë edhe afati i duhur kohor, përkatësisht afati prej 60 ditësh nga paraqitja e aktit individual, si dhe ankimi integral i cili duhet t'i përmbajë të gjitha elementet e listuara në Ligj. Në këtë kuptim, ankimi mund t'i kthehet ankimuesit për ta rishikuar.

Nëse ankimi kushtetues pranohet përkatësisht vlerësohet si i pranueshëm, Gjykata Kushtetuese e shqyrton në një seancë të mbyllur ose mund të mbajë seancë dëgjimore. Nëse pranohet ankimi kushtetues, Kolegji ose Gjykata Kushtetuese mund ta pezullojë zbatimin e aktit individual që është kontestuar me ankimin kushtetues në seancë të mbyllur, nëse nga zbatimi i tij do të shfaqeshin pasoja të dëmshme vështirë të evitueshme.

4 Constitution of the Republic of Slovenia, <https://www.us-rs.si/legal-basis/constitution/?lang=en>

5 Constitutional Court Act of the Republic of Slovenia, <https://www.us-rs.si/media/the.constitutional.court.act-zusts.pdf>

Gjykata Kushtetuese, me aktvendim, ose e hedh poshtë padinë kushtetuese si të pabazë ose e merr në konsideratë dhe e anulon ose shfuqizon plotësisht ose pjesërisht aktin individual dhe ia kthen çështjen autoritetit përgjegjës për të vendosur ndaj tij. Nëse Gjykata Kushtetuese konsideron se akti i kontestuar individual bazohet në një akt normativ ose akt të përgjithshëm i miratuar për ushtrimin e autorizimeve publike, mund të ngrejë procedurë për verifikimin e kushtetutshmërisë ose ligjshmërisë së aktit të atillë normativ apo aktit të atillë të përgjithshëm dhe të vendosë duke zbatuar dispozitat e Kreut IV të këtij Ligji.

Nëse Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për të njëjtën çështje kushtetuese dhe e ka marrë në konsideratë ankimin, me aktvendimin me të cilin e merr në konsideratë ankimin kushtetues, ajo plotësisht ose pjesërisht e shfuqizon ose anulon aktin individual dhe ia kthen çështjen autoritetit kompetent të vendosë për të njëjtin në përputhje me nenin 60 të këtij Ligji.

Nëse Gjykata Kushtetuese shfuqizon ose anulon një akt individual, ajo mund të vendosë gjithashtu për një të drejtë apo liri të kontestuar nëse një gjë e këtillë është e nevojshme për të shmangur pasojat që tashmë janë shfaqur me anulimin e aktit individual, ose nëse një gjë e këtillë e kërkon natyra e së drejtës kushtetuese ose të lirisë dhe nëse një vendim i tillë mund të merret në bazë të informacioneve të përfshira në shkresat e çështjes. Vendimi i specifikuar në paragrafin e mëparshëm zbatohet nga autoriteti përgjegjës për zbatimin e aktit individual të cilin Gjykata Kushtetuese e shfuqizoi ose anuloi dhe e zëvendësoi me vendimin e saj. Nëse nuk ka një autoritet kompetent konform akteve normative në fuqi, atëherë Gjykata Kushtetuese përcakton.

Në nëntor 2023, Instituti i të Drejtave të Njeriut organizoi një vizitë studimore në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë ku, së bashku me përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u shkëmbyen njohuri në lidhje me funksionimin e ankimit kushtetues si mekanizëm për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave. Në takimet nga përfaqësuesit e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Sllovenisë u apostrofua se ankimi kushtetues si mekanizëm është sanksionuar në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë dhe jo në Kushtetutë. Ankimi paraqitet në afat prej 60 ditësh nga dita e paraqitjes së aktit individual kundër të cilit lejohet ankimi kushtetues. Në raste të jashtëzakonshme, Gjykata Kushtetuese mund të vendosë për një ankim kushtetues që është parashtruar pas skadimit të afatit të caktuar.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Sllovenisë mban statistika për ankime kushtetuese identike ose të ngjashme, me ç'rast nga përvoja e tyre prej tre dekadash u theksua se shumica e ankimeve të paraqitura kushtetuese i referohen nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Gjatë përpilimit të raportit për ankimet e paraqitura kushtetuese, këshilltarët detyrimisht duhet ta citojnë praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatës së Drejtësisë të BE-së, kurse në varësi të natyrës së çështjes, citohet edhe praktika e Gjykatës Kushtetuese të Gjermanisë.

## 3.2. Republika e Kroacisë

Kushtetuta e Republikës së Kroacisë<sup>6</sup> në nenin 125, alineja 5, përcakton se Gjykata Kushtetuese vendos për paditë kushtetuese kundër vendimeve individuale të autoriteteve të pushtetit qendror, autoriteteve të njëjësive të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale dhe subjekteve juridike me autorizime publike kur ato vendime shkelin të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të drejtën për vetëqeverisje lokale dhe rajonale të garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kroacisë.

---

6 Ustav Republike Hrvatske, <https://www.zakon.hr/z/94/Ustav-Republike-Hrvatske>



Ligji Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kroacisë<sup>7</sup> në nenin 62 përcakton se çdokush mund të paraqesë padi kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese nëse konsideron se akti individual i një autoriteti shtetëror, një autoriteti të vetëqeverisjes lokale dhe rajonale ose një subjekt juridik me autorizime publike, i cili ka vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij ose për shkak të dyshimit ose akuzës për shkak të një veprimi të dënueshëm, shkeljes së të drejtës së njeriut ose lirisë themelore të garantuar me Kushtetutë, përkatësisht të drejtën për vetëqeverisje lokale dhe rajonale të garantuar me Kushtetutë. Ngjashëm me modelin slloven, edhe në Kroaci mundësia e paraqitjes së padisë kushtetuese kufizohet me shterimin i mjeteve juridike në dispozicion. Gjykata Kushtetuese mund të ngrejë procedurë për padi kushtetuese edhe para se të jetë shteruar procedura ligjore, në rast se të drejtat dhe detyrimet e palës ose dyshimi apo akuza për shkak të veprës penale nuk janë vendosur nga gjykata brenda një kohe të arsyeshme ose në rast se me aktin individual të kontestuar shkelen rëndë të drejtat kushtetuese, ndërkaq është më se e qartë se me mos ngritjen e procedurës kushtetuese gjyqësore mund të shfaqen pasoja të rënda dhe të parikuperueshme për parashtruesin e padisë kushtetuese. Në atë rast, Gjykata Kushtetuese do t' i caktojë gjykatës kompetente një afat brenda të cilit gjykata duhet të vendosë në mënyrë meritore për të drejtat dhe detyrimet, përkatësisht për akuzën e veprës së kryer penale nga pala.

Sa i përket veprimit suspenziv, si rregull, procedura e ngritur nuk e pezullon ekzekutimin e aktit individual deri në përfundimin e procedurës, përveç kur ekzekutimi i tij do t' i shkaktonte dëm parashtruesit që vështirë se mund të rikuperohej dhe nëse prolongimi i ekzekutimit nuk është i dëmshëm për interesin publik.

Kusht për pranueshmërinë e padisë kushtetuese është t' i referohet shkeljes të së drejtës kushtetuese, me ç'rast Gjykata Kushtetuese e Kroacisë e specifikon rolin e saj si mbrojtëse e të drejtave themelore. Nëse e pranon padinë kushtetuese, Gjykata Kushtetuese do ta shfuqizojë aktin me të cilin është bërë shkelja e të drejtës së mbrojtur. Është e rëndësishme të theksohet se nëse konstaton se e drejta kushtetuese e parashtruesit të padisë kushtetuese është shkelur jo vetëm me aktin e kontestuar, por edhe me ndonjë akt tjetër të miratuar në atë rast, Gjykata Kushtetuese do të vendosë ta shfuqizojë, tërësisht ose pjesërisht, atë akt.

### 3.3. Republika e Serbisë

Sipas nenit 170 të Kushtetutës së Republikës së Serbisë,<sup>8</sup> ankimi kushtetues mund të paraqitet kundër akteve ose veprimeve individuale të autoriteteve ose organizatave shtetërore të cilave u janë besuar autorizime publike, me të cilat u shkelen ose mohohen të drejtat dhe liritë e njeriut ose të pakicave të garantuara me Kushtetutë, nëse janë shterur ose nuk janë parashikuar mjete të tjera ligjore për mbrojtjen e tyre.

Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Serbisë,<sup>9</sup> e kufizon të drejtën e çdo personi për të paraqitur ankim kushtetues për shkelje të të drejtave të njeriut ose të pakicave, përkatësisht të drejtave të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Serbisë.

Në përputhje me Ligjin, ankim kushtetues paraqitet më së voni 30 ditë nga dita e parashtrimit të aktit individual, përkatësisht nga dita e ndërmarrjes së veprimit me të cilin është shkelur e drejta e njeriut ose e drejta e pakicës e garantuar me Kushtetutë.

Si rregull, paraqitja e ankimit kushtetues nuk e prolongon ekzekutimin e aktit, përveç rasteve kur me ekzekutimin e tij mund të shfaqen dëme të pariparueshme për parashtruesin, por,

7 Ustavni zakon o Ustavnom sudu Republike Hrvatske, [https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2002\\_05\\_49\\_967.html](https://narodne-novine.nn.hr/clanci/sluzbeni/2002_05_49_967.html)

8 Устав Републике Србије, <http://www.ustavni.sud.rs/page/view/139-100028/ustav-republike-srbije#d6>

9 Закон о Уставном суду Републике Србије, <http://www.ustavni.sud.rs/page/view/141-100030/zakon-o-ustavnom-sudu>

njëherësh, prolongimi nuk duhet të jetë në dëm të interesit publik ose në dëm të të drejtave të personave të tretë.

Është interesant të theksohet se në modelin serb të ankimit kushtetues, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në rastet kur shkelen disa të drejta dhe liri të njeriut ose të pakicave të garantuara me Kushtetutë të më shumë personave, por vetëm disa prej tyre kanë paraqitur ankim kushtetues, vlen edhe për personat që nuk kanë paraqitur ankim kushtetues, ndërkaq janë në të njëjtën situatë juridike.

Kur Gjykata Kushtetuese, me vendim, do të konstatojë se është shkelur ose pamundësuar ndonjë e drejtë ose liri e njeriut ose e pakicës e garantuar me Kushtetutë, atëherë ajo mund ta anulojë atë akt, ta ndalojë ekzekutimin e veprimit ose të urdhërojë masa tjera që do të ndërmerren për të korrigjuar shkeljet, pasojat e dëmshme ose pamundësitë e shfaqura nga akti ose veprimi.

### 3.4. Mali i Zi

Në përputhje me Kushtetutën e Malit të Zi<sup>10</sup>, siç është përcaktuar në nenin 149, paragrafin 3, Gjykata Kushtetuese vendos për ankimin kushtetues lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe lirive të garantuara me Kushtetutë, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive.

Në përputhje me Ligjin Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi,<sup>11</sup> ankim kushtetues mund të paraqitet nga çdo person fizik ose juridik, organizatë, grup personash dhe forma të tjera të organizimit që nuk e kanë statusin e personit juridik, nëse pretendojnë se e drejta ose liria e tyre e njeriut, e garantuar me Kushtetutë, është shkelur me një akt individual, me veprimin ose mosveprimin e autoritetit shtetëror, autoritetit të pushtetit qendror, autoritetit të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht pushtetit lokal, personit juridik ose personit tjetër që ushtron autorizime publike.

Ankimi kushtetues mund të paraqitet pas shterimit të mjeteve juridike efektive, që nënkupton se parashtruesi i ankimit kushtetues i ka përdorur të gjitha mjetet juridike për të cilat ka pasur të drejtë në përputhje me ligjin, duke i përfshirë edhe mjetet juridike efektive dhe të jashtëzakonshme dhe mjetet e tjera të veçanta juridike, mjetet juridike që mund të çojnë në ndryshimin e një akti individual në favor të parashtruesit të ankimit kushtetues, përkatësisht deri në pezullimin ose korrigjimin e veprimit, gjegjësisht deri në pezullimin e veprimit ose mosveprimit të autoritetit shtetëror, autoritetit të pushtetit qendror, autoritetit të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht pushtetit lokal, personit juridik ose personit tjetër që ushtron autorizime publike.

Ankesa kushtetuese mund të paraqitet edhe para shterimit të mjeteve juridike efektive të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, nëse parashtruesi i ankimit kushtetues provon se mjeti juridik për të cilin ai ka të drejtë në rastin konkret nuk është ose nuk do të ishte efektiv.

Ankimi kushtetues paraqitet, në përputhje me nenin 69 të Ligjit Kushtetues për Gjykatën Kushtetuese të Malit të Zi, brenda 60 ditëve nga dita e paraqitjes së aktit individual kundër të cilit mund të paraqitet ankim në përputhje me dispozitat e ligjit në fjalë, nga dita e pezullimit të veprimeve me të cilat është shkelur e drejta ose liria e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, nëse kundër atij veprimi nuk ka mjet juridik efektiv ose nga dita e fundit në të cilën ishte e mundur të shmanget mosveprimi me të cilin është shkelur e drejta ose liria e njeriut, të garantuara me Kushtetutë, nëse kundër këtij mosveprimi nuk ka mjet juridik efektiv.

Ashtu si edhe në modelet e analizuara paraprakisht të ankimit kushtetues përkatësisht të padisë kushtetuese, ankimi kushtetues nuk ka efekt suspenziv në ekzekutimin e aktit individual,

10 Ustav Crne Gore, [https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/skladiste/blog\\_2/objava\\_105/fajlovi/Ustav%20Crne%20Gore.pdf](https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/skladiste/blog_2/objava_105/fajlovi/Ustav%20Crne%20Gore.pdf)

11 Zakon o Ustavnom sudu Crne Gore, [https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/skladiste/blog\\_2/objava\\_105/fajlovi/Zakon%20o%20Ustavnom%20sudu%20Crne%20Gore%202015\\_2\\_.pdf](https://www.ustavnisud.me/ustavnisud/skladiste/blog_2/objava_105/fajlovi/Zakon%20o%20Ustavnom%20sudu%20Crne%20Gore%202015_2_.pdf)

përveç rasteve kur parashtruesi në pretendimet e tij bën të mundur që nga ekzekutimi mund të shfaqen pasoja të dëmshme të parikuperueshme.

Ankimi kushtetues i deklaruar ose i paraqitur u dërgohet edhe personave të tjerë, të drejtat dhe detyrimet e të cilëve do të prekeshin nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese me të cilin pranohet ankimi kushtetues, ndërsa këta persona kanë të drejtë të prononcohen në lidhje me ankimin kushtetues të paraqitur brenda një afati të përcaktuar nga Gjykata.

Gjatë vendimmarrjes, Gjykata Kushtetuese kufizohet duke vendosur për shkeljet e mundshme të të drejtave ose lirive të garantuara me Kushtetutë, të cilat janë listuar në ankimin kushtetues.

Nëse Gjykata Kushtetuese e pranon ankimin kushtetues, atëherë merr vendim me të cilin shfuqizohet tërësisht ose pjesërisht ai akt ndërsa çështja i kthehet autoritetit i cili e ka nxjerrë atë akt. Nëse gjatë procedurës është pezulluar efekti juridik i aktit të kontestuar ndërkohë që konstatohet shkelje, atëherë Gjykata Kushtetuese, duke e marrë vendimin për pranimin e ankimit kushtetues, do ta përcaktojë mënyrën e kompensimit të drejtë të parashtruesit për shkak të shkeljeve të pësuarra të të drejtave ose lirive të njeriut.

Në rast se shkelja kryhet me veprim, atëherë gjykata kushtetuese me vendimin për pranimin e ankimit kushtetues do ta ndalojë veprimin dhe do të urdhërojë miratimin e aktit ose ndërmarrjen e masave dhe veprimeve me të cilat do të korrigohej përkatësisht shmangen pasojat e dëmshme.

### 3.5. Bosnja e Hercegovina

Shteti i Bosnjë e Hercegovinës është një rast unik dhe interesant në lidhje me rregullimin e saj të përgjithshëm shtetëror-juridik, duke e përfshirë edhe rolin e Gjykatës Kushtetuese në rendin e saj juridik përkatësisht juridiksionin e saj për të vepruar mbi mjetin juridik ankimi kushtetues gjegjësisht padia kushtetuese, i cili në rastin e rendit juridik të këtij shteti ka edhe një emërtim të veçantë: apelim.

Fillimisht, Bosnja e Hercegovina, akoma e ka kushtetutën, e cila në fakt është një aneks i një marrëveshje paqeje, përkatësisht Marrëveshja e Paqes e Dejtonit e vitit 1995 që i dha fund luftës së përgjakshme nga vitit 1992 deri në vitin 1995, e cila e ndryshoi plotësisht rregullimin shtetëror-juridik në krahasim me rendin pas shpalljes së pavarësisë në mars të vitit 1992, por edhe krahasim me ish njësinë federative e ish-RSFJ-së. Së këtejmi, Bosnja e Hercegovina përbëhet nga dy entitete (njësi federale me elemente konfederale) të quajtura Federata e Bosnjë e Hercegovinës (kryesisht e populluar nga boshnjakët dhe kroatët) dhe Republika Srpska (kryesisht e populluar nga serbët) dhe një kondominium i quajtur Distrikti Brčko (i populluar nga të tre popujt konstituiv) logjika e ekzistencës së të cilave është më shumë e natyrës gjeo-strategjike se çdo justifikim tjetër. Entiteti Federata e Bosnjë e Hercegovinës edhe pse, në thelb, është njësi federale e shtetit, ka një strukturë federale, përkatësisht është e ndarë në kantone me pushtetin e vet legjislativ dhe ekzekutiv dhe në këtë kuptim është një "federatë brenda federatës". Në nivelin qendror, shteti përbëhet nga tre popujt konstituiv boshnjakët, serbët dhe kroatët, ka autoritete të pushtetit qendror (Asambleja Parlamentare si bartëse e pushtetit ligjvënës, Presidenca e përbërë nga një përfaqësues prej të tre popujve konstituiv si kreu kolektiv i shtetit, Këshilli i Ministrave si bartës i pushtetit ekzekutiv, Gjyqësori dhe Prokuroria e Bosnjë e Hercegovinës me juridiksionin për t'i ndjekur autorët e veprave penale të parashikuara me legjislacionin e përbashkët dhe Gjykata Kushtetuese e Bosnjë e Hercegovinës, e cila është, *de facto*, gjykata më e lartë në shtet. Një autoritet i veçantë i pushtetit është Përfaqësuesi i Lartë në Bosnjë e Hercegovinë, i cili nominohet nga Këshilli për Implementimin e Paqes (anëtare të të cilit janë shtetet nga Aleanca Perëndimore plus Rusia), kompetenca kryesore e të cilit është të kujdeset për zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit me anekset e tij përkatësisht funksionimi normal i shtetit në përputhje me rendin juridik. Aspekti më i rëndësishëm i pozicionit

të tij janë të ashtuquajturat Autorizimet e Bonit me të cilat Përfaqësuesi i Lartë ka të drejtë të shfuqizojë, anulojë ose miratojë akte normative ose t'i zëvendësojë nga pozita politike titullarët e autorizimeve publike nëse me veprimet ose vendimet e tyre politike e rrezikojnë paqen ose zbatimin e Marrëveshjes së Paqes të Dejtonit.

Në përputhje me Kushtetutën e Bosnjë e Hercegovinës<sup>12</sup>, neni VI, Gjykata Kushtetuese përbehet nga nëntë anëtarë, nga të cilët 4 anëtarë zgjidhen nga Dhoma e Përfaqësuesve të Federatës së Bosnjë e Hercegovinës, dy anëtarë nga Kuvendi i Republikës Srpska dhe tre anëtarë zgjidhen nga Kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas konsultimit me Presidencën. Gjyqtarët e zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut nuk mund të jenë shtetas të Bosnjë e Hercegovinës, përkatësisht ata janë të huaj, gjë që është një zgjidhje unike në të drejtën kushtetuese krahasuese. Megjithatë, kjo mënyrë e emërimit kishte garanci kushtetuese vetëm për përbërjen e parë të Gjykatës për një mandat pesëvjeçar, ndërsa për gjyqtarët e emëruar nga Kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në mandatet pasuese ekziston mundësia kushtetuese që Asambleja Parlamentare e Bosnjë e Hercegovinës të miratojë një ligj me të cilin do përcaktohet një mënyrë tjetër e zgjedhjes (diçka që, deri më tani, nuk është respektuar).

Sipas Rregullave të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës<sup>13</sup> (akti themelor me të cilin rregullohet puna e Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë e Hercegovinës), Gjykata shqyrton apelimet vetëm nëse ata kundërshtojnë një aktgjykim, përkatësisht një vendim, nëse shterojnë të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion konform legjislacionit dhe nëse paraqitet brenda 60 ditëve nga dita kur parashtruesi e ka pranuar vendimin në lidhje me mjetin e fundit juridik efektiv që e ka përdorur.

Gjykata Kushtetuese, si përjashtim, mund të shqyrtojë një apelim edhe kur nuk ka vendim të një gjykate kompetente, nëse apelimi pretendon shkelje serioze të të drejtave dhe lirive të mbrojtura me Kushtetutë ose me konventat ndërkombëtare që zbatohen në Bosnjë e Hercegovinë.

Apelimi, në përputhje me nenin 18 të Rregullave, nuk është i pranueshëm nëse Gjykata nuk është kompetente të vendosë, nëse është anonim, nëse është paraqitur pas afatit të caktuar, nëse është paraqitur nga një person i paautorizuar, nëse bëhet fjalë për çështje që tashmë është vendosur nga Gjykata, ndërkaq nga pretendimet nuk rezulton se ka arsye për rivendosje, nëse parashtruesi e ka abuzuar të drejtën e apelimt, nëse rrethanat juridike kanë ndryshuar dhe nëse apelimi është: *ratione materiae*, *ratione personae* dhe *ratione temporis* inkompatibil me Kushtetutën, nëse parashtruesi nuk ka arritur ta plotësojë atë brenda afatit të caktuar, nëse nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të mundshme ligjrisht, përkatësisht nëse pretendimet dukshëm nuk kanë të bëjnë me të drejtat e mbrojtura me Kushtetutë, ose nëse parashtruesi nuk ka vuajtur pasoja nga shkelja e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë.

Konform nenit 62 të Rregullave, i cili e përcakton veprimin juridik të vendimeve në procedurat lidhur me apelimin, nëse Gjykata Kushtetuese e pranon apelimin, atëherë e shfuqizon vendimin e kontestuar dhe ia kthen çështjen gjykatës ose autoritetit që e ka marrë vendimin për rivendosje, përveç rasteve kur pasojat e shfaqura nga vendimi mund të shmangen në mënyrë tjetër. Në justifikimin e vendimit, Gjykata Kushtetuese vë në dukje se cila e drejtë kushtetuese është shkelur, kurse gjykata përkatësisht autoriteti, vendimi i të cilit është shfuqizuar, e ka për detyrë pa prolongime të marrë një vendim të ri.

Veçanërisht është e rëndësishme dispozita që autoriteti ose gjykata e ka për detyrë t'i përmbahet opinionit juridik të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të mbrojtura me Kushtetutë, për të cilat ka konstatuar Gjykata. Me këtë dispozitë,

---

12 Ustav Bosne i Hercegovine, [https://www.ustavnisud.ba/uploads/documents/ustav-bih-bs\\_1611076095.pdf](https://www.ustavnisud.ba/uploads/documents/ustav-bih-bs_1611076095.pdf)

13 Pravila Ustavnog suda Bosne i Hercegovine, [https://www.ustavnisud.ba/uploads/documents/pravila-bs\\_1611132311.pdf](https://www.ustavnisud.ba/uploads/documents/pravila-bs_1611132311.pdf)

Gjykata Kushtetuese e Bosnjë e Hercegovinës, *de facto*, e ka pozitën e gjykatës më të lartë në vend dhe në instancë të fundit në interpretimin e Kushtetutës së Bosnjë e Hercegovinës, opinioni i së cilës është i detyrueshëm për të gjitha autoritetet e pushtetit pavarësisht nivelit të pushtetit.

### 3.6. Republika Federale e Gjermanisë

Ankimi kushtetues ka historinë më domethënëse dhe më të gjatë në rendin juridik gjerman pas Luftës së Dytë Botërore, përkatësisht miratimi i aktit kushtetues të Republikës Federale të Gjermanisë i quajtur Ligji Themeltar i Republikës Federale të Gjermanisë<sup>14</sup> (ish-Gjermania Perëndimore) në vitin 1949, i cili pas ribashkimit të dy shteteve gjermane në vitin 1990 është i vlefshëm në Republikën Federale të Gjermanisë bashkëkohore.

Duke marrë parasysh se çështja e ankimit kushtetues në Gjermani tashmë është trajtuar në disa publikime në gjuhët rajonale, ndërkaq i fundit është publikimi i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Fondacionit Gjerman për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar (IRZ Foundation) në gjuhën maqedonase si rezultat i një projekti të përbashkët në këtë fushë, ky dokument në vija të shkurta e analizon ankimin kushtetues në rendin juridik gjerman me synimin e vetëm për të prezantuar një pasqyrë gjithëpërfshirëse të kësaj çështjeje gjatë inkorporimit eventual gjithëpërfshirës të këtij mjeti juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në përputhje me Ligjin themelor të Republikës Federale të Gjermanisë, nenin 90, paragrafi 1 nr. 4a dhe 4b dhe nenin 90 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kushdo mund të paraqesë ankim kushtetues me pretendimin për shkeljen e të drejtave themelore ose të drejtave të përcaktuara në nenin 20, paragrafin 4, dhe nenet 33, 38, 101, 103,104 të Ligjit themelor nga autoritetet e pushtetit publik.

Gjykata Kushtetuese Federale mund të përcaktojë antikushtetueshmërinë e një akti të autoriteteve të pushtetit publik, të shpallë një ligj të pavlefshëm ose të shfuqizojë një vendim antikushtetues dhe t'ia kthejë atë në rivendosje gjykatës kompetente.

Ankimi kushtetues ndaj vendimeve të gjykatave dhe autoriteteve administrative lejohet në afat prej një muaji nga dërgesa e tyre tek parashtruesi, me ç'rast ky afat mund të shtyhet për dy javë të tjera nëse afati fillestar i paraqitjes/parashtrimit, me elementët e detyrueshëm të ankimit, nuk mund të respektohet pa fajin e parashtruesit.

Pranueshmëria e ankimit kushtetues kufizohet me shterimin e të gjithë procedurës ligjore të parashikuar dhe të disponueshme, si dhe me të gjitha mundësitë e tjera efektive për korrigjimin e shkeljes eventuale të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Kjo, para së gjithash, ka të bëjë me të gjitha mjetet e parashikuara dhe efektive juridike.

Ligjet, aktet normative me fuqinë e ligjit dhe aktet e tjera të përgjithshme juridike mund të kontestohen me ankim kushtetues vetëm në rast se ato kontestohen drejtpërdrejtë personalisht nga palët e prekura, drejtpërdrejtë dhe në mënyrë të vazhdueshme ankohen, me ç'rast ankimi mund të paraqitet në afat prej një viti nga data e hyrjes në fuqi të akteve normative. Meqenëse, në parim, shkeljet e kryera me aktet e përgjithshme shfaqen me zbatimin e tyre mbi rastet individuale përkatësisht aktet ose veprimet individuale, qëllimi i këtij kufizimi është që palët t'i referohen gjykatave të rregullta për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre të mbrojtura me Kushtetutën e Republikës Federale të Gjermanisë.

Parashtruesit e ankimeve kushtetuese mund të përfaqësojnë veten në procedurë ose mund të avokohen nga një avokat ose profesor i të drejtës i një institucioni shtetëror të arsimit të lartë

---

14 Grundgesetz für die Bundesrepublik Deutschland, <https://www.gesetze-im-internet.de/gg/BJNR000010949.html>

ose nga një institucion i arsimit të lartë nga një shtet anëtar i BE-së, nga një shtet anëtar i Zonës Ekonomike Evropiane ose nga Zvicra me autorizimin për të ushtruar funksionin gjyqësor.

Parakushti themelor për vendimmarrje lidhur me ankimin kushtetues është pranueshmëria e tij. Gjatë vlerësimit të pranueshmërisë së tij, përveç kushteve të specifikuara, është veçanërisht e rëndësishme nëse Gjykata Kushtetuese tashmë ka vendosur për çështjen në fjalë dhe nëse në rast të mos marrjes së vendimit do të kishte pasoja veçanërisht të rënda mbi ankimuesin<sup>15</sup>.

---

15 Merkblatt über Verfassungsbeschwerde zum Bundesverfassungsgericht, [https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Downloads/DE/Merkblatt.pdf;jsessionid=DFD2F840B38FAE4E6C81017C06111886.internet971?\\_\\_blob=publicationFile&v=22](https://www.bundesverfassungsgericht.de/SharedDocs/Downloads/DE/Merkblatt.pdf;jsessionid=DFD2F840B38FAE4E6C81017C06111886.internet971?__blob=publicationFile&v=22)



## 4.

# REKOMANDIME PËR SANKSIONIMIN E ANKIMIT GJITHËPËRFSHIRËS KUSHTETUES NË RENDIN JURIDIK TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE FUQIZIMIN E ROLIT TË GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT SI MBROJTËSE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nenin 110 alineja 3,<sup>16</sup> Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është kompetente t'i mbrojtë liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimeve, asocimin dhe veprimin politik, dhe ndalimin e diskriminimit të qytetarëve mbi bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike. Nga kjo dispozitë kushtetuese rezulton se Gjykata Kushtetuese ka juridiksion për të mbrojtur të drejtat dhe liritë në rendin tonë juridik, juridiksion ky që kufizohet në tre grupe të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Juridiksioni kushtetues i Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut i përcaktuar në dispozitën në fjalë të Kushtetutës trajtohet në detaje në Rregulloren e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kreu IV, nenet 51-57<sup>17</sup> me titull "Procedura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave sipas nenit 11, alineja 3 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë së Veriut." Në përputhje me dispozitat e theksuara, të drejtë për të paraqitur kërkesë për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave ka çdo qytetari i cili pretendon se me një veprim ose akt individual i është shkelur një e drejtë. Kjo kërkesë mund të paraqitet në afat prej dy muajsh nga dita e dërgesës së aktit individual përfundimtar ose të formës së prerë, përkatësisht nga dita e vënies në dijeni për ndërmarrjen e veprimit me të cilin është kryer shkelja, por jo më vonë se pesë vjet nga dita e ndërmarrjes së tij. Në dispozitat e mëtejshme, procedura shqyrtohet në detaje duke përfshirë përmbajtjen e kërkesës, afatet për të vepruar sipas procedurës paraprake në të cilën kërkesa i adresohet për prononcim vendimmarrësit të aktit individual përkatësisht autoritetit i cili ka ndërmarrë një veprim me të cilin shkelen të drejtat. Në Rregulloren e Punës përcaktohet se më së voni në afat prej 30 ditësh nga momenti i kalimit të çështjes te gjyqtari-raportues paraqitet referat për seancë ose Gjykata do të njoftohet për ecurinë e procedurës, me ç'rast ky afat mund të shtyhet në mënyrë efektive. Gjykata Kushtetuese, sipas rregullit, vendos për këto kërkesa në bazë të seancës dëgjimore publike në të cilën mund të thirren, përveç pjesëmarrësve në procedurë, edhe Avokati i Popullit, por edhe persona, autoritete apo organizata të tjera.

Sipas nenit 56 të Rregullores së Punës, Gjykata Kushtetuese me vendim konstaton se a ekziston shkelje dhe varësisht nga kjo, do ta anulojë aktin individual, ose do ta ndalojë veprimin me të cilin është kryer shkelja apo me aktvendim do ta refuzojë kërkesën. Është e rëndësishme të theksohet se Gjykata Kushtetuese, në ato pak raste deri më tani, në të cilat ka konstatuar shkelje, në asnjë rast nuk ka anuluar një akt individual, një aktgjykim përkatësisht nuk e ka

16 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://www.sobranie.mk/content/Odluki%20USTAV/UstavSRSM.pdf>

17 Rregullorja e Punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut, [https://ustavensud.mk/?page\\_id=4605](https://ustavensud.mk/?page_id=4605)

aplikuar këtë autorizim nga Rregullorja e Punës. Aplikimi i tij mund të krijojë probleme shtesë nëse anulohet një aktgjykim gjyqësor duke e pasur parasysh mosharmonizimin e Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese me legjislacionin relevant.<sup>18</sup>

Gjatë procedurës, Gjykata është kompetente të miratojë një masë të përkohshme, përkatësisht aktvendim për pezullimin e ekzekutimit të aktit ose veprimit individual deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.

Në vazhdim të tekstit të dokumentit për politika publike prezantohen rekomandimet për zgjerimin dhe fuqizimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e RMV-së:



### **Sanksionimi i padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues në rendin juridik përmes amendimit të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut**

Sanksionimi i padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues e hap çështjen e përcaktimit të përfshirjes së të drejtave dhe lirive të garantuara me Kushtetutën e RMV-së për mbrojtjen e të cilave do të ishte kompetente Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Çështja e prioritizimit të të drejtave dhe lirive të caktuara është jashtëzakonisht e rëndësishme për fuqizimin e rolit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut si mbrojtëse e të drejtave dhe lirive të njeriut, por edhe të mos përcaktohet një juridiksion shumë i gjerë që do të çonte në probleme gjatë funksionimit të Gjykatës.

Sanksionimi i padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues mund të realizohet thjesht duke e zgjeruar juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me të drejtat dhe liritë që i mbron. Në atë rast, Gjykata Kushtetuese e RMV-së do të duhet të miratojë një Rregullore të re të Punës në të cilën do ta shqyrtojë në tërësi procedurën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive në aspektin e juridiksionit të zgjeruar, por edhe ta përcaktojë veprimin juridik të vendimeve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive në mënyrë që të rritet efektiviteti ose ndikimi i tyre mbi rendin juridik.

Varianti i dytë ka të bëjë me sanksionimin e padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues përmes amendimit të Kushtetutës ta përfshijë përveç zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe rregullimin e procedurës dhe efektin juridik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në vetë Kushtetutën. Ky variant, përsëri, do ta hapë diskutimin e nevojës së parashikimit të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese me dispozitë eksplicite kushtetuese, duke e pasur parasysh natyrën specifike juridike të Rregullores aktuale të Punës së Gjykatës Kushtetuese, e cila, për nga përmbajtja por edhe për nga pozita e saj në rendin juridik, devijon nga çështjet tipike të cilat përcaktohen me Rregulloren e Punës, të cilat më shumë kanë të bëjnë me organizimin teknik të punës së institucionit. Ky diskutim i zgjeruar do të ishte një tentativë për reformimin e plotë të gjyqësorit kushtetues në vendin tonë.

Sanksionimi i padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues do të kontribuojë në rritjen e konsiderueshme të numrit të çështjeve në një periudhë të shkurtër kohore të cilat do t'i trajtojë Gjykata Kushtetuese e RMV-së. Së këtejmi, është me rëndësi të vlerësohet ekipimi kadrovik i Gjykatës Kushtetuese për të vepruar në kushtet e rritjes së konsiderueshme të vëllimit të punës, por edhe trajnimi i shërbimit profesional për t'i trajtuar këto çështje. Në varësi të analizës, nuk përjashtohet edhe nevoja për trajnimin shtesë të gjyqtarëve.

18 Shih më shumë: Spirovski Igor, Margarita Caca Nikollovska, Analizë e vendimeve dhe aktvendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me kërkesat e paraqitura për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave, Instituti i të Drejtave të Njeriut, Shkup, 2023, [skedar:///C:/Users/Aleksandar/Downloads/MK\\_IHR-Analiza\\_Ustaven\\_23.pdf](skedar:///C:/Users/Aleksandar/Downloads/MK_IHR-Analiza_Ustaven_23.pdf)



Sanksionimi i padisë/ankimit gjithëpërfshirës kushtetues do të ketë efekt mbi reduktimin e numrit të çështjeve para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Realizimi i këtij rekomandimi e nënkupton edhe arritjen në një shkallë të gjerë të konsensusit politik në Kuvend dhe shmangien e kushtëzimit politik tipik për të gjitha ndryshimet e mëparshme të Kushtetutës së RMV-së, siç ishte rasti edhe me tentativat e pasuksesshme për sanksionimin e padisë/ankimit kushtetues në të kaluarën.



### Zgjerimi i juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive përmes interpretimit të zgjeruar të dispozitës së nenit 110 të GjKRMV-së dhe pa amendimin e KRMV-së.

Duke e pasur parasysh pozitën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut si instanca më e lartë që e interpreton Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese mund të përfshihet në zgjerimin efektiv të juridiksionit të saj për të mbrojtur të drejtat dhe liritë, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi. Neni 110, alineja 3 e Kushtetutës së RMV-së përcakton se Gjykata Kushtetuese "i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe qytetarit që kanë të bëjnë me lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, asocimit dhe veprimit politik dhe ndalimin e diskriminimit ndaj qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, përkatësisë fetare, kombëtare, sociale dhe politike." Duke e marrë parasysh zhvillimin jashtëzakonisht dinamik të mbrojtjes nga diskriminimi, duke e përfshirë praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata Kushtetuese e RMV-së, përmes interpretimit të juridiksionit të saj, në masë të konsiderueshme mund t'i zgjerojë bazat e mbrojtjes nga diskriminimi, veçanërisht në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi mbi bazë të përkatësisë sociale. Kjo qasje, edhe pse në teorinë tradicionale të traditës kontinentale juridike konsiderohet si shkelje mbi parimet e sundimit të ligjit dhe ndarjes së pushtetit, është një praktikë gjithnjë e më e pranishme në vendimet e gjykatave të instancës më të lartë madje edhe në rendet juridike kontinentale që janë, në parim, jashtëzakonisht "rigjide" ndaj opinioneve dhe praktikave të tilla.

Realizimi i këtij rekomandimi, në afat të mesëm, e eviton kushtëzimin politik tipik për të gjitha ndryshimet e mëparshme të Kushtetutës së RMV-së, siç ishte rasti edhe me tentativat e pasuksesshme për sanksionimin e padisë/ankimit kushtetues në të kaluarën.

Megjithatë, realizimi i këtij rekomandimi nënkupton një reterim të konsiderueshëm nga praktika e deritanishme e Gjykatës dhe domosdoshmërisht duhet të përfshijë edhe një shkallë të lartë konsensusi midis gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Nga ana tjetër, nevojitet një debat gjithëpërfshirës dhe i argumentuar me publikun ekspert.



## Fuqizimi i efektivitetit të vendimeve të GjKRMV-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive pa e amenduar GjKRMV-së, por duke e ndryshuar Ligjin për Procedurë Kontestimore

Efekti i realizimit të këtij rekomandimi ka të bëjë me fuqizimin e efektivitetit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive në rast se konstatohet shkelje duke ndryshuar nenin 400 të Ligjit për Procedurë Kontestimore<sup>19</sup>. Me fjalë të tjera, synimi konsiston me atë që, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, me të cilat është konstatuar shkelje e të drejtës së njeriut, të jenë bazë për përsëritjen e procedurës në gjykatën e cila gjykoi në shkallë të parë.

Meqë një veprim i tillë parashikohet për vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Ligjin për Procedurë Kontestimore, atëherë shumë duhet të përfshihen edhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese kombëtare.

Edhe pse për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji nevojitet një shumicë prej dy të tretave në Kuvend, megjithatë ndjeshmëria politike e kësaj çështjeje është shumë më e ulët në krahasim me çështjen e ndryshimit të Kushtetutës.

<sup>19</sup> Konform nenit 400 të Ligjit për Procedurë Kontestimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut "(1) Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut do të konstatojë shkelje të ndonjë të drejte të njeriut ose të lirive themelore të parashikuara në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe në Protokollet Shtesë të Konventës, të cilat Republika e Maqedonisë i ka ratifikuar, pala mundet, në afat prej 30 ditësh nga vendimi përfundimtar i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të paraqesë kërkesë në gjykatë në Republikën e Maqedonisë që ka gjykuar në shkallën e parë në procedurë në të cilën është marrë vendimi me të cilin është shkelur ndonjë nga të drejtat e njeriut ose liritë themelore për ndryshimin e vendimit me të cilin është shkelur ajo e drejtë ose liri themelore. (2) Në procedurën e paragrafit (1) të këtij neni, në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat për përsëritjen e procedurës. (3) Gjatë përsëritjes së procedurës, gjykatat janë të detyruara t'i respektojnë pikëpamjet juridike të artikuara në aktgjykimin përfundimtar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut me të cilin është konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut."

